

AGJENCIA
E BURIMEVE
NATYRORE
Nr. 1624/2
25.11.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Prof. 8106

URDHËR

Nr. 269, Datë 11.11.2022

PËR

**KONTROLLIN DHE MONITORIMIN NË VEPRIMTARINË MINERARE TË
PËRPUNIMIT PËR OPERACIONET E SELEKSIONIMIT, THYERJES,
FRAKSIONIMIT, PASURIMIT DHE PROCESIVE METALURGJIKE PËR
GRUPIN E MINERALEVE METALORË E NDËRTIMOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", i ndryshuar,

URDHËROJ:

- 1- Të gjitha fabrikat e pasurimit, metalurgjitë, impiantet e thyerjes, fraksionimit dhe seleksionimit duhet të mbajnë dokumentacion të rregullt për të gjitha proceset e përpunimit të mineralit, treguesit sasior dhe cilësor të mineralit të papërpunuar dhe të përpunuar.
- 2- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kryen kontrollin për:
 - a- Realizimin e treguesve cilësor dhe sasior, të treguesit të rikuperimit të koncentratit për fabrikat e përpunimit të mineraleve metalorë, rikuperimin dhe treguesit sasiorë e cilësorë të ferro-kromit për uzinat e shkrirjes së mineralit, si dhe sasinë e produkteve të prodhuara, për grupin e mineraleve ndërtimorë;
 - b- Përputhshmërinë e sasive të produkteve të shitura dhe treguesve cilësorë të mineralit të përpunuar, sipas faturave tatimore, me raportimet e bëra në Aneksin 1, të këtij urdhri për mineralet metalorë;
 - c- Mënyrën e depozitimit të mbetjeve;

- d- Ruajtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve
- e- Skemën e trajtimit të ujrave dhe pluhurit me qëllim plotësimin e standarteve ligjore të mbrojtjes së mjedisit.
- 3- Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë minerare të përpunimit, çdo vit, brenda 30 ditëve të vitit pasardhës, duhet të dërgojnë online (portali: raport.akbn.gov.al) pranë institucionit të AKBN-së, informacionin vjetor të veprimtarisë minerare të përpunimit. Format i informacionit vjetor për veprimtarinë minerare të përpunimit të realizuar nga zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, për operacionet e seleksionimit, thyerjes, fraksionimit, pasurimit, dhe proceseve metalurgjike të mineraleve metalore dhe të ndërtimit, duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkuar në aneksin 1, të këtij urdhri.
- 4- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të udhëzojë subjektet mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe raportimeve online të informacioneve.
- 5- Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRI" at the top, "MINISTRI E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the inner edge, and "TIRANË" at the bottom. The signature is written in a cursive style.

ANEKSI 1

FORMATI I INFORMACIONIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË MINERARE TË PËRPUNIMIT QË DËRGOHET ONLINE NË AKBN NGA ZOTËRUESIT E LEJEVE MINERARE TË SHFRYTËZIMIT PËR OPERACIONET E SELEKSIONIT, THYERJES, FRAKSIONIMIT, PASURIMIT DHE METALURGISË, PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JO METALORE, TË NDËRTIMIT, BITUMET DHE QYMYRET

Raporti financiar dhe teknik duhet të dërgohet online (portal:raport.akbn.gov.al) pranë AKBN- së çdo vit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës kalendarik vjetor.

Shoqëria _____

Objekti ku zhvillohet aktiviteti _____

Periudha raportuese _____

Viti _____

Formati i tabelës informuese vjetore:

Nr	Emërtimi	Njësia	Parashkrimi	Realizimi	%
1	Përpunim minerali në fabrika pasurimi dhe impiante përpunimi				
	Sasia e mineralit që përpunohet	ton			
	Përmbajtja e metalit në mineralin që përpunohet	%			
	Përmbajtja e H ₂ O në mineralin që përpunohet	%			
	Sasia e mineralit të përpunuar (koncentrati)	ton			
	Përmbajtja e metalit në mineralin e përpunuar	%			
	Përmbajtja e H ₂ O në mineralin e përpunuar	%			
	Sasia e mbetjeve që del nga përpunimi	ton			
	Përmbajtja e metalit në mbetje	%			
	Koeficienti i rikuperimit	%			
2	Përpunimi i mineralit në metalurgji				
	Sasia e mineralit ose koncentratit që përpunohet	ton			

	Përmbajtja e metalit në mineralin ose koncentratit që përpunohet	%			
	Përmbajtja e H ₂ O në mineralin ose koncentratit që përpunohet	%			
	Sasia e mineralit të përpunuar (ferrokrom)	ton			
	Përmbajtja e metalit në mineralin e përpunuar (ferrokrom)	%			
	Përmbajtja e H ₂ O në mineralin e përpunuar (ferrokrom)	%			
	Sasia e mbetjeve që del nga përpunimi	ton			
	Përmbajtja e metalit në mbetje	%			
	Koeficienti i rikuperimit	%			
3	Përpunimi mineraleve ndërtimor me thyerje-fraksionim				
	Sasia e mineralit që përpunohet	ton			
	Sasia e mineralit të përpunuar	ton			